



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 28 tetor 2024
Nr. ref.:RK 2566/24

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI66/23

Parashtrues

Veli Commerce Sh.p.k

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit E.Rev.nr.2/2023 të 16 janarit 2023
të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga kompania Veli Commerce Sh.P.K. me seli në Gjilan, e përfaqësuar nga Bejtush Isufi, avokat në Komunën e Prishtinës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [E.Rev.nr.2/2023] të 16 janarit 2023 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), në lidhje me Aktgjykimin [Kom.Dh.Sh.II.nr.1537/2022] të 17 nëntorit 2022 të Gjykatës Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Komerciale), dhe me Aktgjykimin [1.EK.nr.652/2021] të 8 marsit 2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Ekonomik (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [E.Rev.nr.2/2023] të 16 janarit 2023 të Gjykatës Supreme, me të cilat pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ) si dhe nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e përgjithshme] dhe paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
5. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e Punës e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 01/2023, është botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe ka hyrë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e publikimit të saj. Prandaj, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së Punës në fjalë, e cila e shfuqizoi Rregulloren e Punës së Gjykatës Kushtetuese nr. 01/2018. Në këtë drejtim, në përputhje me rregullin 78 (Dispozita Tranzicionale) të Rregullores së Punës nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së Punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2018, të miratuar më 31 maj 2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 21 mars 2023, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 31 mars 2023, Kryetarja e Gjykatës me Vendimin [nr. GJR. KI66/23] caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi, gjyqtar raportues dhe me vendimin [nr. KSH. KI66/23] Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërzhaliu Krasniqi (kryesuese), Safet Hoxha (anëtar) dhe Remzije Istrefi-Peci (anëtare).
8. Më 4 prill 2023, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Po atë ditë njoftoi dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës, duke i dorëzuar një kopje të kërkesës.

9. Më 01 tetor 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

10. Nga shkresat e lëndës, rezulton që çështja ka të bëjë me kontestin gjyqësor ndërmjet palës paditëse "Emona" sh.p.k, i iniciuar me padinë e parashtruar dhe parashtrimet e paraqitura gojarisht dhe me shkrim gjatë procesit gjyqësor, kundër parashtruesit të kërkesës bazuar në çështje të rregulluara me Ligjin për Markat Tregtare. Objekt kontesti, ndër të tjera, ishte pretendimi se marka tregtare "Emona Brand" me figurën e zogut ishte e regjistruar në Agjencinë për Pronësi Industriale (në tekstin në vijim: API), figurë të cilën e kishte në përdorim edhe parashtruesi i kërkesës "Veli Commerce" sh.p.k.
11. Më 25 mars 2014, Agjencia për Pronësi Industriale përmes Vendimit [nr.12629] kishte regjistruar markën tregtare të paditësit "Emona Brand", me figurën e zogut me afat skadimi deri më datën 3 dhjetor 2018.
12. Pala paditëse "Emona" sh.p.k pas regjistrimit të markës tregtare me Vendimin e lartcekur, kishte paraqitur kërkesë për veprim në Doganën e Kosovës, për ndalimin e mallrave të importuara të të paditurit, përkatësisht të parashtruesit të kërkesës, me pretendimin që shkelin markën tregtare të tij. Dogana e Kosovës në periudhën korrik dhe shtator të vitit 2014, kishte vepruar sipas kërkesës ashtu që kishte ndaluar mallrat e parashtruesit të kërkesës çaj i zi me shenjën e zogut. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës në periudhën korrik-shtator 2014, kishte importuar produktin çaj i zi me shenjën "Drini Tee" me figurën e zogut, në sasi prej 23,660 kg, dhe në sasi prej 720 kg, në total prej 24,380 kg.
13. Më 4 korrik 2014, Dogana e Kosovës e kishte njoftuar paditësin "Emona" sh.p.k. se parashtruesit të kërkesës i ishte bërë ndalimi i një sasive të çajit "Drini Tee", i cili produkt ishte i importuar nga Shrilanka. Kjo ndalesë i ishte bërë në bazë të kërkesës së paditësit për mbrojtjen e markës tregtare të cilën pretendonte se e kishte në pronësi, bazuar në Certifikatën për markë tregtare të lëshuar përmes Vendimin [12629] të 25 marsit 2014.
14. Më 29 shtator 2015, API përmes Vendimit [01/VSH] shfuqizoi Vendimin [nr.12629] të 25 marsit 2014.
15. Më 20 mars 2017, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Komerciale nxjerr Aktvendimin [C.nr.422/488/2014] për masën e sigurisë të lirimit të mallit nga Dogana e Kosovës, që mallin e ndaluar në bazë të Aktvendimit të datës 16 shtator 2014, me numër të protokollit [980/08.2.5 ZBD Ferizaj], t'ia dorëzoi në posedim dhe qarkullim të lirë propozuesit të sigurimit "Veli Commerce", ndërsa nga arsyetimi i këtij Aktvendimi rezulton se sasia e mallit të liruar është 23,660 kg.
16. Më 17 shtator 2018, API përmes Vendimit [01/9101]: e (i) shfuqizoi vendimin e lartcekur [01/VSH] dhe (ii) e kishte lënë në fuqi Vendimin [12629] e 25 marsit 2014. Rrjedhimisht, pas përfundimit të rastit administrativ në procedurë ankimore, vendimi [12629], kishte mbetur në fuqi.

Procedura gjyqësore për mbrojtje të markës tregtare

17. Më 22 korrik 2014, kompania "Emona sh.p.k" -pala e interesuar, paraqiti padi kundër parashtruesit të kërkesës për mbrojtjen e markës tregtare, e cila mori shenjën [II.EK.nr.422/14].

18. Më 25 shtator 2014, kompania "Emona sh.p.k" paraqiti padinë e dytë për mbrojtjen e markës tregtare kundër parashtruesit të kërkesës e cila u regjistrua me shenjën [II. Ek. nr. 488/14].
19. Më 26 janar 2015, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit i bashkoi lëndët [II.EK.nr.422/14] dhe [II. Ek. nr. 488/14].
20. Më 20 janar 2016, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kundërpadi në Gjykatën Themelore për shkak të kompensimit të dëmit material dhe jo material. Më anë të kundërpadisë kërkoi që të refuzohet kërkesëpadia e të kundërpaditurës "Emona sh.p.k" si e pabazuar, dhe të miratohet kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës si e bazuar, si dhe të vërtetohet se kompania "Emona sh.p.k" i ka shkaktuar dëm parashtruesit të kërkesës.
21. Më 9 qershor 2021, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [I.Ek.nr.488/14]: (I) miratoi padinë e kompanisë "Emona sh.p.k" ku konstatoi se kompania "Veli Commerce" sh.p.k kishte shkelur të drejtën e markës tregtare të "Emona Brand", duke importuar produktin "Drini Brand/Tee" në sasi prej 24,380 kg, që mbante një shenjë të ngjashme me figurën e zogut, e cila ishte e regjistruar si markë tregtare me numër 12629 më 25 mars 2014. Gjykata e detyroi "Veli Commerce" sh.p.k të shkatërronte mallin e importuar nën mbikëqyrjen doganore dhe me shpenzimet e veta. Po ashtu, "Veli Commerce" sh.p.k u obligua të mbulonte shpenzimet e magazinimit dhe të ndërpriste importimin dhe qarkullimin e mëtejshëm të çajit të zi Ceyloni me markën Drini Brand/Tee. Gjithashtu, ajo u detyrua të tërhiqte produktin nga tregu dhe të publikonte aktgjykimin në një gazetë ditore të Kosovës.
22. Në anën tjetër, Gjykata refuzoi padinë e "Veli Commerce" sh.p.k si të pabazuar, e cila kishte kërkuar që të konfirmohej se importi i produktit çaj i zi nuk kishte shkelur markën tregtare të regjistruar me numër 12629 dhe kishte kërkuar kompensim për dëmet e shkaktuara nga ndalimi i importit, duke përfshirë: dëmet për koston e furnizimit, fitimin e humbur për periudhën deri në vitin 2017, si dhe kamatëvonesën prej 8%. Përfundimisht, Gjykata po ashtu e detyroi "Veli Commerce" sh.p.k të paguante kompanisë "Emona sh.p.k" shumën prej 5,820.00 € për shpenzimet e procedurës gjyqësore.
23. Kundër këtij aktgjykimi, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë për shkak të (i) shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore; (ii) konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe (iii) zbatimit të gabuar të së drejtës materiale si dhe vendimit mbi shpenzimet e procedurës, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të aprovohet në tërësi kundërpadia ose aktgjykimi të prishet në tërësi dhe lënda të kthehet në rigjykim. Në anën tjetër Paditësja kompania "Emona sh.p.k" nuk kishte dhënë përgjigje në ankesë.
24. Më 16 tetor 2021, Gjykata e Apelit të Kosovës përmes Aktgjykimit [Ae.nr.170/21] aprovoi si të themeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës, prishi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore [I.Ek.nr.488/14] dhe i ktheu të njëjtës rastin në rigjykim dhe rivendosje. E njëjta arsyei që Gjykata Themelore në pikën I.2 të dispozitivit të Aktgjykimit ka vendosur që ti shkatërron mallrat në sasi prej 24,380 kg, gjë që në rastin konkret rezulton se ka bërë tejkalim të kërkesëpadisë në kundërshtim me nenin 2.1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, i cili përcakton që "gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse".
25. Pra, përmes Aktgjykimit të lartcekur, Gjykata e Apelit theksoi që "[...] në shkresat e lëndës rezulton se gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e saj C.nr. 422, 488/2014 të datës 20/03/2017 e ka detyruar kundërshtarin e sigurimit Dogana e Kosovës, që mallin e ndaluar në bazë të Aktvendimit të datës 16/09/2014, me numër të protokollit

980/08.2.5 ZBD Ferizaj, t'ia dorëzoj në posedim dhe qarkullim të lirë propozuesit të sigurimit "Veli Commerce", me seli në Gjilan, ndërsa nga arsyetimi i këtij Aktvendimi rezulton se sasia e mallit të liruar është 23,660 kg, prandaj gjykata e shkallës së parë gjatë vendimmarrjes nuk i ka pasur parasysh këto rrethana relevante'.

Rigjykimi i çështjes gjyqësore për mbrojtjen e markës tregtare

26. Më 8 mars 2022, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [I.EK.nr.652/21]: (I) miratoi si të bazuar kërkesëpadinë e kompanisë "Emona sh.p.k"; (I/1) Vërtetohet se "Veli Commerce" sh.p.k, me importimin e mallit - qaj i zi "Drini Brand/Tee", në sasi prej 24,380 kg, ka shkelur markën tregtare të paditësit "Emona Brand" me figurën e zogut, me numër regjistrimi [12629] të datës 25 mars 2014; (I/2) Detyrohet "Veli Commerce" sh.p.k, që nën mbikëqyrjen doganore të bëjë shkatërrimin e mallit të importuar të përshkruar si në paragrafin I/I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në sasinë e mbetur në depo doganore, prej 720 kg, me shpenzimet e veta të shkatërrimit të mallit, brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi; (I/3) Detyrohet "Veli Commerce" sh.p.k, që të bartë shpenzimet e magazinimit të mallit të përshkruar në pikën "I/1", të dispozitivit të këtij aktgjykimi; (I/4) Detyrohet "Veli Commerce" sh.p.k, që të ndërpresë importin dhe vendosjen e mëtejshme në qarkullim të lirë të produktit çaj i zi Ceyloni, me shenjën Drini Brand/Tee, të mos importoj e as prodhoj në të ardhmen ndonjë lloj tjetër të vajit që përmban emrin tregtar "Drini Brand Tee", me shenjën e zogut, si dhe të largoj nga tregu në tërë territorin e Republikës së Kosovës produktin çaj i zi Ceyloni me shenjën Drini Brand/Tee, me shenjën e zogut; (I/5) Detyrohet "Veli Commerce" sh.p.k, që të bëjë shpalljen publike të këtij aktgjykimi në njëërën nga gazetatat e përditshme që publikohen në Republikën e Kosovës; (II) Refuzohet si e pa bazuar kërkesëpadia e "Veli Commerce" sh.p.k, me të cilin është kërkuar që të vendoset si në vijim: (II.1) Të vërtetohet se "Veli Commerce" sh.p.k me importimin e produktit çaj i zi, në sasi prej 24,380 kg, nuk ka shkelur të drejtat e markës tregtare nga vendimi me numër 12629, i lëshuar nga API; (II/2) Të vërtetohet se me ndaljen e importimit të produktit çaj i zi në sasi prej 24,380 kg, si pasojë e kërkesës së paditësit, të paditurit i janë shkaktuar dëmet si në vijim: (A) Në emër të dëmit - kostos së furnizimit të mallit kontestues si pasojë e bllokimit të importit, në shumën prej 78,487.60 €; (B) Në emër të fitimit të humbur për shkak të bllokimit të importit shumën prej 39,824.40 €; (C) Në emër të fitimit të humbur për shkak të pa mundësisë së importeve nga viti 2014, deri në tetor të vitit 2018, shumën prej 316,016.49 €; dhe (D) Në nën-pikat a, b, dhe c të paragrafit II, të njihet kamatë vonesa prej 8%, nga dita kur është shkaktuar dëmi; (II/3) Të detyrohet paditësi- "Emona sh.p.k" që t'ia kompensoj "Veli Commerce" sh.p.k shumën si në paragrafin II më lartë, në afatin prej 7 ditësh, prej plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm. (III) Detyrohet parashtruesi i kërkesës që paditësit- "Emona sh.p.k" t'ia paguaj shumën prej 6,665.50 €, në emër të kompensimit të shpenzimeve të procedurës kontestimore.
27. Më 28 mars 2022, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë kundër Aktgjykimit të lartcekur, duke propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi dhe të miratohet kundërpadia si e bazuar.
28. Më 17 nëntor 2022, Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, përmes Aktgjykimit [Kom.Dh.Shk.II.nr.1537/22] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin [I.EK.nr. 652/2021] e 8 marsit 2022, të Gjykatës Themelore. Në arsyetimin e aktgjykimit të saj, Gjykata Komerciale theksoi si në vijim: "Gjykata Komerciale, dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vepruar kur ka konstatuar se me vendimin Agjencisë për Pronësi Industriale të datës 17.08.2018, ka mbet në fuqi vendimi për regjistrimin e markës tregtare me nr.12629, i dt.25.03.2014 (me efekt nga data e nxjerrjes së tij), andaj në kohën e shkeljes së ndodhur (korrik - shtator kur jane ndaluar mallrat nga Dogana e

Kosovës), rezulton që marka tregtare ka qenë e regjistruar në emër të paditësit, dhe ka prezantuar bazë për të kërkuar mbrojtje gjyqësore.”

29. Më 16 dhjetor 2022, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë për revizion kundër aktgjykimit të lartcekur dhe propozoi që Gjykata Supreme të aprovojë revizionin dhe aktgjykimet e shkallës së parë dhe të dytë t'i prishë dhe lëndën ta kthejë në rivendosje ose të njëjtit t'i ndryshojë dhe të aprovojë kundërpadinë, në tërësi si të bazuar.
30. Më 16 janar 2023, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [E.Rev.nr.2/2023] refuzoi revizionin e parashtruesit të kërkesës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale [Kom.Dh.sh.II.nr.1537/2022] të 17 nëntorit 2022, duke theksuar në arsyetim: *“Në revizionin e të paditurit - kundër paditësit, janë paraqitur pretendime për shkelje thelbësore procedurale nga neni 182.2 pika g, të LPK-së, duke e cekur në gjykatën e instancës më të ulët kanë mbrojtur një marke tregtare e cila sipas pretendimit të paditurit - kundër paditësit në atë kohe ka qenë objekt shqyrtimi në një procedurë administrative dhe një faze ka qenë i anuluar ky vendim. Gjykata Supreme nuk e aprovoi këtë pretendim të revizionit sepse në procedurë të mëvonshme administrative ishte konstatuar se anulimi i kësaj marke tregtare ka qenë i kundërligjshëm dhe me një vendim përfundimtar administrativ ishte shfuqizuar ky vendim për çregjistrimin e markës tregtare të paditësit - kundër paditurit. Kjo nuk i jep të drejtë të paditurit -kundër paditësit që të përdorë markën tregtare qoftë edhe në kontest administrativ, por se titulli administrativ përfundimtarë është në dobi të paditësit të kundër paditurit.*

[...]

Gjykata Supreme e Kosovës pajtohet me konstatimin se nga fotot që gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se produkti i paditësit dhe të paditurit kanë ngjashmëri ndërmjet tyre dhe mundësia e shaktimit të konfuzionit është e madhe pasi që shenja e përdorur në produktet e të paditurës asociojnë në shenjen e regjistruar si markë tregtare nga paditësja, mallrat janë të ngjashme respektivisht të së njëjtës kategori dhe ndërmarrjet janë në konkurrencë me njëra tjetrën.

[...]

Gjykata Supreme e Kosovës, ka vlerësuar se marka tregtare e kryen funksionin për identifikimin e prejardhjes, ndërsa qëllimi kryesor i Ligjit mbi Markat Tregtare është mbrojtja e konsumatorëve nga konfuzioni ose mashtrimi lidhur me prejardhjen e mallrave, sipas nenit 8 par. 1, nën. par. 1.2 i Ligjit mbi Markat Tregtare, pronari i një marke të regjistruar nuk ka nevojë të vërtetojë konfuzionin që faktikisht është krijuar nga përdorimi i markës identike ose të ngjashme, por vetëm mundësinë e krijimit të një konfuzioni tek konsumatorët.”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

31. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi [E.Rev.nr.2/2023] i Gjykatës Supreme bie në kundërshtim me të drejtat dhe liritë themelore të përcaktuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNj-së si dhe me nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit 1 të KEDNj-së.

Në lidhje me pretendimin për shkeljen e të drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm

32. Parashtruesi i kërkesës thekson se gjykatat e rregullta gjatë procedurës gjyqësore nuk kanë ofruar një gjykim të drejtë dhe të paanshëm në kuptim të nenit 31 të Kushtetutës. Parashtruesi pretendon se gjykatat e rregullta e kanë gjykuar çështjen e cila ka qenë në shqyrtim para tyre, sikurse të mos kishte ekzistuar asnjë mëdyshje në lidhje me pronësinë e markës tregtare të supozuar nga kompania “Emona sh.p.k”. Më tej,

parashtruesi i kërkesës thekson se duke u bazuar në shkresat e lëndës, sidomos përmes Vendimit [Nr. 01/VSH] të MTI-së dhe Aktvendimit të Gjykatës Themelore [C.nr. 422/488/2014] të datës 20 marsit 2017, provohet qartazi se kompania “Emona sh.p.k” nuk ka qenë pronar i markës tregtare për territorin e Republikës së Kosovës në kohën e dorëzimit të padisë. Kontesti për pronësinë e markës tregtare me shenjën e kanarinës vazhdon vetëm në Republikën e Kosovës ende, në mes të paditësit dhe pronarit të vërtetë të kësaj marke tregtare, kompanisë nga Sri Lanka.

33. Parashtruesi i kërkesës ka pasur pritje legjitime se e drejta e tij për të importuar produktin nga kompania zvicerane “Drini Tee GmbH”, marka tregtare e të cilit është e regjistruar pranë autoriteteve kompetente në Zvicër që nga viti 2002 dhe në Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale që nga viti 2004 dhe me vlefshmëri të licencës deri më 2024, do të mbrohet përmes Kushtetutës dhe Konventës që zbatohet në Kosovë.
34. Po ashtu, parashtruesi i kërkesës potencon se gjykatat e rregullta për më tepër e kanë ngarkuar atë me detyrimin për largimin e produkteve të kompanisë zvicerane “Drini Tee GmbH” nga territori i Republikës së Kosovës, ndonëse parashtruesi i kërkesës nuk është pronar i kësaj marke tregtare, dhe se gjykatat e rregullta kanë injoruar faktin që marka tregtare në procedurë administrative i është njohur kompanisë “Emona sh.p.k” në vitin 2018, ndërsa padia është dorëzuar në vitin 2014. Andaj, pretendon se përmes zbatimit retroaktiv të vendimit administrativ, gjykatat kanë cenuar qartazi parimin e sigurisë juridike.
35. Parashtruesi i kërkesës pretendon se duke mos respektuar çështjen e gjykuar përmes Aktvendimit të Gjykatës Themelore [C.nr. 422/488/2014] të 20 marsit 2017, është shkelur e drejta e tij për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Dhe se përmes aktvendimit në fjalë është konstatuar se në kohën e dorëzimit të padisë nuk ka ekzistuar bazë ligjore, pra nuk ka ekzistuar pronësia e kompanisë “Emona sh.p.k” ndaj ndonjë marke tregtare që e monopolizon të drejtën e tyre për përdorimin e shenjës së kanarinës. Po ashtu, parashtruesi i kërkesës thekson se ndonëse malli i konfiskuar ishte liruar përmes këtij aktvendimi, pasi kompania “Emona sh.p.k” nuk është pronar ligjor i markës tregtare, kërkojnë në mënyrë retroaktive asgjësimin e mallit.
36. Më tej, parashtruesi i kërkesës duke ju referuar parimit të barazisë së palëve, thekson se gjykatat e rregullta nuk kanë marrë për bazë asnjë dëshmi të dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës, i cili ka ofruar dëshmi se ai nuk është pronari i markës “Drini Tee GmbH”, por pronar është kompania zvicerane me të njëjtin emër. Gjithashtu, thekson se gjykatat nuk kanë marrë parasysh asnjë nga vendimet e institucioneve publike të Republikës së Kosovës, përfshirë vendimet gjyqësore të cilat dëshmojnë esencën e çështjes në shqyrtim, pra faktin se parashtruesi i kërkesës nuk është përgjegjës për shkeljen e markës tregtare dhe faktin se kompania “Emona sh.p.k” në kohën e dorëzimit të padisë, pra periudhën për të cilën zhvillohet kontesti, nuk ka qenë pronar i markës tregtare. Dhe se rrjedhimisht sipas parashtruesit të kërkesës, gjykatat nuk kanë marrë parasysh as dokumentet të cilat dëshmojnë se në territorin e Republikës së Kosovës për vite me radhë janë shitur produkte me brendin e kanarinës, përfshirë vet kompaninë “Emona sh.p.k”. Pra që kompanitë kosovare kanë qenë importuese dhe jo pronare të brendeve të ndryshme të çajit të kanarinës. Sipas parashtruesit të kërkesës i tërë gjykimi bazohet në një vendim administrativ të MTI-së, i cili i njeht vetëm në Kosovë pronësinë e kompanisë “Emona sh.p.k” dhe jo pronarëve të vërtetë dhe atë vendim administrativ e zbaton në mënyrë retroaktive në një periudhë kohore kur ai nuk mund të gjejë zbatim.

Në lidhje me shkeljen e të drejtës për mbrojtje të pronës

37. Parashtruesi i kërkesës thekson se gjatë gjykimit atij i është vënë obligimi për të kompensuar kompaninë “Emona sh.p.k” në emër të shkeljes së markës tregtare dhe se ndërhyrja e autoriteteve publike, për shkak të procedurave arbitrare në rastin e tij, ndonëse në shikim të parë krijon përshtypjen e një veprimi legjitim dhe proporcional, në të vërtetë paraqet një ndërhyrje të paligjshme dhe arbitrare. Parashtruesi i kërkesës thekson se përpos shpenzimeve në raport me autoritetet publike, ngarkohet me pagesën e një kompensimi në emër të shkeljes së markës tregtare, ndonëse ai nuk është pronar i markës që supozohet se ka shkelur markën e kompanisë “Emona sh.p.k”.
38. Parashtruesi i kërkesës thekson se ka pasur pritje legjitime se gëzon të drejtën të vazhdojë të importojë një produkt, të cilin e ka importuar sikurse kompania “Emona sh.p.k” për vite me radhë dhe se këto garanci janë të rregulluara me Ligjin për Markat Tregtare. Më tej, parashtruesi i kërkesës potencon se ka pritje legjitime që prona e tij, në këtë rast e drejta e tij për të mos u ngarkuar me detyrime arbitrare financiare, do të jetë e mbrojtur nga autoritetet publike në rast se ai vepron në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe se parimi i sigurisë juridike është i mishëruar dhe zbatohet në të gjitha nenet e Konventës, rrjedhimisht edhe në raport me mbrojtjen e pronës. Parashtruesi i kërkesës thekson se u ka ofruar gjykatave të rregullta një vendim gjyqësor në të cilin ishte dëshmuar se ai nuk ka shkelur markën tregtare dhe se nuk ka bazë as për konfiskim të mëtutjeshëm të mallit e as bazë për ta ngarkuar me detyrime financiare ndaj autoriteteve publike, si dhe as në raport me persona fizikë apo juridikë të së drejtës private.
39. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që: (i) të deklarojë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së si dhe shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNj-së; (iv) të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [E.Rev.nr.2/2023] dhe të gjitha vendimet dhe veprimet e autoriteteve publike të lidhura me këtë aktgjykim.; (v) t’ia kthejë Gjykatës Komerciale çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje dhe të publikojë këtë aktgjykim në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Dispozitat relevante kushtetuese

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. *“Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
 2. *Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.”*
- [...]
6. *Ndihma juridike falas do t’u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi.”*

[...]

Neni 46
[Mbrojtja e Pronës]

1. *“E drejta e pronës është e garantuar.*
2. *Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.*
3. *Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohehet.*
4. *Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.*
5. *Prona intelektuale mbrohet me ligj.”*

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6
(E drejta për një proces të rregullt)

1. *“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohe shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.*
2. *Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.*
3. *Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:*
 - a) *të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;*
 - b) *t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;*
 - c) *të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;*
 - d) *të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës; e. të ndihmohet falas nga një përkthyes në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq.”*

Protokolli Nr.1 i KEDNJ-së

Neni 1
(Mbrojtja e pronës)

“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk çenojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.”

LIGJI Nr. 04/L-026 PËR MARKAT TREGTARE

KREU II EFEKTET E MARKËS TREGTARE

Neni 8

Të drejtat e fituara nga marka tregtare

1. Marka e regjistruar është e drejtë ekskluzive e pronarit të saj. Pronari i markës tregtare të regjistruar ka të drejtën të ndalojë palët e treta të përdorin pa lejen e tij:

1.1. çdo shenjë, që është identike me markën tregtare, për mallra ose shërbime që janë identike me ato për të cilat është regjistruar marka tregtare;

1.2. çdo shenjë që është identike ose e ngjashme me markën apo që, për shkak të njëjlojshmërisë apo ngjashmërisë së mallrave ose shërbimeve, për të cilat përdoret shenja, me mallrat apo shërbimet, që mbulohen nga marka e regjistruar, mund të shkaktojnë konfuzion te publiku, ku përfshihet edhe mundësia e asociimit së shenjës me markën tregtare;

1.3. çdo shenjë, që është identike apo e ngjashme me markën tregtare për produktet dhe shërbime të ndryshme nga ato për të cilat është regjistruar marka tregtare, kur kjo e fundit ka reputacion në Republikën e Kosovës dhe nga përdorimi i shenjës, pa shkak të arsyeshem, realizohet një përfitim i padrejtë ose dëmtohet natyra dalluese apo emri të njohur të markës.

2. Sipas paragrafit 1. të këtij neni pronari i markës gjithashtu mund të ndalojë këto veprime:

2.1. vendosja e shenjës në mallra apo në paketimet e tyre;

2.2. hedhja e mallrave në treg, ofrimi i tyre për shitje dhe ofrimi i shërbimeve duke përdorur këtë shenjë, ose magazinimi i tyre për këto qëllime;

2.3. përdorimi i shenjës gjatë importimit apo eksportimit të mallrave;

2.4. përdorimi i shenjës në shkresa zyrtare dhe në reklamim.

3. Të drejtat që rrjedhin nga regjistrimi i markës kanë efekt mbi palët e treta që nga data e publikimit të regjistrimit të markës tregtare. Mund të kërkohet kompensim për shkeljen e markës që ndodhin pas datës së publikimit të aplikimit të markës tregtare, shkeljet të cilat pas publikimit të regjistrimit të markës tregtare duhet të ndalohen. Gjykata që ka në shqyrtim çështjen nuk mund të vendosë për këtë çështje derisa të publikohet regjistrimi.

KREU XIII MBROJTJA CIVILO – JURIDIKE

Neni 95
Subjektet që kanë të drejtë të kërkojnë mbrojtjen e të drejtave

Padinë në rast të shkeljes së të drejtave të markës tregtare sipas këtij ligji kanë të drejtë ta ushtrojnë pronari i markës tregtare, pronari i licencës ekskluzive sipas kontratës apo bartësi i së drejtës së markës tregtare.

Neni 96
Procedura për konstatimin dhe ndalimin e shkeljes

1. Pronari i markës tregtare mund të parashtrojë padi në gjykatë për konstatimin e shkeljes së të drejtës së markës tregtare kundër personit i cili ka shkelur te drejtën e markës duke kryer pa autorizim njërën nga veprimet e cekura në nenin 8, paragrafët 1. dhe 2. të këtij ligji duke kërkuar:

1.1. vërtetimin e shkeljes së markës;

1.2. ndalimin e shkeljes dhe ndalimin e vazhimit të shkeljeve të tilla dhe të ngjashme në të ardhmen;

1.3. ndalimin dhe ndërprerjen e mëtutjeshëm të shkeljes së të drejtave të fituara në bazë të nenit 8 paragrafët 1. dhe 2. të këtij ligji, që kanë shkaktuar apo përbëjnë tentim serioz për shkeljen e mundshme të markës së tij tregtare.

2. Veprimet e cekura në paragrafit 1., nën-paragrafët 1.1, 1.2. dhe 1.3. të këtij neni që gjithashtu mund të bëhen kundër personave të cilët gjatë aktivitetit të tyre ekonomike kanë kryer shërbime duke shkelur markën apo bëjnë kërcënim për shkelje të të drejtave të markës.

Neni 97
Kërkesa për konfiskimin dhe shkatërrimin e produkteve

1. Pronari i të drejtës së markës tregtare mund të inicioj procedurë gjyqësore kundër çdo personi që ka shkelur të drejtat e markës tregtare duke kryer pa autorizim njërën nga veprimet e cekura në nenin 8, paragrafët 1. dhe 2. të këtij ligji, duke kërkuar që produktet që përbëjnë shkelje të markës tregtare të largohen nga tregu, të konfiskohen apo shkatërrohen me shpenzimet e shkelësit.

2. Gjykata cakton masën përkatëse kundër të paditurit me shpenzime të të paditurit përveç rasteve kur ekzistojnë arsye të veçanta që të mos ndërmerret një veprim të tillë.

3. Shqiptimi i masës nga gjykata sipas paragrafit 1. të këtij neni duhet të jetë në proporcion me shkeljen.

Neni 98
Kërkesa për kompensim të dëmit

1. Pronari i markës tregtare mund të inicioj padi kundër personit i cili i ka shkaktuar dëm duke kryer pa autorizim veprimet sipas nenit 8, paragrafët 1. dhe 2. të këtij ligji, dhe të kërkoj kompensimin e dëmit.

2. Pronari i markës tregtare mund inicioj padi kundër personit i cili ka kryer pa autorizim veprimet sipas nenit 8 paragrafi 1. dhe 2. të këtij ligji. duke kërkuar

kompensimin ne shumen qe ai e ka kërkuar ne kontratën për licencën nëse ajo ekziston.

3. Pronari i markës tregtare mund të inicioj padi kundër personit i cili ka kryer pa autorizim veprimet e cekura në nenin 8 paragrafi 1. dhe 2. të këtij ligji, i cili ka përfituar pa bazë ligjore duke shkelur markën tregtare të huaj, dhe të kërkoj kthimin apo kompensimin e atyre përfitimeve, sipas dispozitave të përgjithshme për përfitimin pa bazë.

4. Kërkesat sipas paragrafit 1., 2. dhe 3. të këtij neni nuk e përjashtojnë njëra tjetrën.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

40. Gjykata, së pari, shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
41. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafit 4, të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

Neni 21
[Parimet e Përgjithshme]

[...]

4. “Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme”.

Neni 113
[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

42. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, në cilësinë e personit juridik, sikurse është përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 21 të Kushtetutës, ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejné për individët dhe personat juridikë (shih rastin e Gjykatës [KI195/20](#), me parashtrues *Aigars Kesengfelds*, pronar i institucionit financiar jo-bankar “Monego”, Aktgjykim i Gjykatës i 19 prillit 2021, paragrafi 63; [KI41/09](#), parashtruesi i kërkesës *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendim për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14).
43. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve, 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

“Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi”.

44. Sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, që konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [E. rev. nr. 2/2023] të 16 janarit 2023, të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka qartësuar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
45. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 34 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, rregulli 34 (2) përcakton që:

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, kur parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj.”

46. Rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Me saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpall një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës (shih rastin [KIO4/21](#), parashtrues *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri i 12 majit 2021, paragrafi 26 shih gjithashtu rastin [KI175/20](#), parashtrues *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri i 27 prillit 2021, paragrafi 37).

47. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “*qartazi e pabazuar*” në tërësinë e saj ose vetëm përkritazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “*pretendime qartazi të pabazuara*”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “*të shkallës së katërt*”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*”; (iii) pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”; dhe në fund, (iv) pretendime “*konfuzë dhe të paqarta*.”
48. Në këtë kontekst, si dhe në tekstin në vijim, në mënyrë që të vlerësojë pranueshmërinë e kërkesës, përkatësisht në rrethanat e rastit konkret, vlerësimi nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
49. Në dritën e këtij sfondi normativ, Gjykata sjell në vëmendje se çështja thelbësore në rrethanat e rastit konkret, ka të bëjë me pretendimin e parashtruesit të kërkesës lidhur me mos-arsyetim të vendimit gjyqësor të cilin e ndërlihdë me shkelje të vendimit *res judicata*. Nga shkresat e lëndës, rezulton që çështja kishte të bëjë me kontestin ndërmjet palës paditëse “*Emona*” sh.p.k, me padinë e parashtruar, kundër parashtruesit të kërkesës, për mbrojtjen e markës tregtare “*Emona Brand*” me figurën e zogut. Në anën tjetër edhe parashtruesi i kërkesës kishte ushtruar kundërpadi për shkak të kompensimit të dëmit material dhe jo material. Fillimisht Gjykata Themelore aprovoi padinë e kompanisë “*Emona sh.p.k*” si dhe vërtetoi se parashtruesi i kërkesës, me importimin e mallit “*Drini Brand/ Tee*”, në sasi prej 24,380 kg, kishte shkelur markën tregtare të paditësit “*Emona Brand*”. Pas ankesës së paraqitur nga ana e parashtruesit të kërkesës Gjykata e Apelit aprovoi si të themeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e prish Aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe i ktheu të njëjtës rastin në rigjykim dhe rivendosje, pasi që në rastin konkret rezulton se ka bërë tejkalim të kërkesëpadisë. Në rigjykim të çështjes, Gjykata Themelore përsëri aprovoi si të bazuar kërkesëpadinë e kompanisë “*Emona Brand*”. Ankesën e parashtruesit ndaj vendimit të lartcekur e refuzoi si të pabazuar Dhoma e shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale. Përfundimisht, Gjykata Supreme refuzoi kërkesën për revizion të parashtruesit të kërkesës.
50. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës i konteston konstatimet e gjykatave të rregullta para Gjykatës, duke pretenduar shkelje të (I) nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, si rezultat i mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor; të cilin e ndërlihdë me mos respektimin e çështjen e gjykuar si dhe mosrespektimin e parimit të barazisë së armëve; si dhe pretendimet për: (II) shkelje të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.

(I) Parimet për vendim të arsyetuar gjyqësor të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës

51. Përkritazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata fillimisht thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së (përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet [Hadjianastassiou kundër Greqisë](#), nr.12945/87, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; [Van de Hurk kundër Holandës](#), nr. 16034/90, Aktgjykim i 19 prillit 1994; [Hiro Balani kundër Spanjës](#), nr. 18064/91, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; [Higgins dhe të tjerët](#)

[kundër Francës](#), nr. 20124/92, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; [Garcia Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; [Hirvisaari kundër Finlandës](#), nr. 49684/99, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001; [Suominen kundër Finlandës](#), nr. 37801/97, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; [Buzescu kundër Rumanisë](#), nr. 61302/00, Aktgjykim i 24 majit 2005; [Pronina kundër Ukrainës](#), nr. 63566/00, Aktgjykim i 18 korrikut 2006; dhe [Tatishvili kundër Rusisë](#), nr. 1509/02, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007. Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në [KI22/16](#), parashtrues *Naser Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017; [KI97/16](#), parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykim i 9 janarit 2018; [KI143/16](#), parashtrues *Muharrem Blaku* dhe të tjerët, Aktvendim për papranueshmëri i 13 qershorit 2018; [KI87/18](#), parashtrues i kërkesës *IF Skadiforsikring*, Aktgjykim, i 27 shkurtit 2019, dhe [KI24/17](#), parashtrues *Bedri Salihu*, Aktgjykim, i 27 majit 2019, [KI35/18](#), parashtrues *Bayerische Versicherungsverband*, Aktgjykim, i 11 dhjetorit 2019; si dhe rastin e Gjykatës [KI230/19](#), parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 135).

52. Në parim, Gjykata thekson se garancitë e mishëruara në nenin 6 të KEDNj-së përfshijnë detyrimin që gjykatat të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre (shih, rastin e GJEDNj-së, [H. kundër Belgjikës](#), nr. 8950/80, Aktgjykimi i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53; si dhe shih rastin e Gjykatës [KI230/19](#), parashtrues *Albert Rakipi*, të cituar më lart, paragrafi 139 dhe rastin [KI87/18](#), parashtrues *IF Skadiforsikring*, cituar më lartë, paragrafi 44).
53. Gjykata po ashtu thekson se bazuar në praktikën e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të parimit i cili i referohet administrimit të duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave duhet të përmbajnë arsyetimin mbi të cilin ato bazohen në vlerësimin dhe vendimmarrjen e tyre. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit konkret. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm (shih në mënyrë të ngjashme rastet e GJEDNj-së: [Garcia Ruiz kundër Spanjës](#), cituar më lartë, paragrafi 29; [Hiro Balani kundër Spanjës](#), cituar më lartë, paragrafi 27; dhe [Higgins dhe të tjerët kundër Francës](#), cituar më lartë, paragrafi 42; shih, po ashtu, rastin e Gjykatës [KI97/16](#), parashtrues *IKK Classic*, të cituar më lart, paragrafi 48; dhe rastin [KI87/18 IF Skadeforsikring](#), të cituar më lart, paragrafi 48). Duke mos kërkuar një përgjigje të detajuar për secilën ankesë të ngritur nga parashtruesi i kërkesës, ky obligim nënkupton që palët në procedurë gjyqësore mund të presin që të pranojnë një përgjigje specifike dhe eksplicite ndaj pretendimeve të tyre që janë vendimtare për rezultatin e procedurës së zhvilluar (shih rastin [Moreira Ferreira kundër Portugalisë \(Nr.2\)](#), nr. 19867/12, Aktgjykim i 11 korrikut 2017, paragrafi 84 dhe të gjitha referencat e përdorura aty; si dhe rastin e Gjykatës [KI230/19](#), parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 137).
54. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe praktikës së saj gjyqësore ku ajo vlerëson se arsyetimi i vendimit duhet të theksojë raportin ndërmjet konstatimeve të meritës dhe shqyrtimit të provave nga njëra anë, dhe konkluzionet ligjore të gjykatës, nga ana tjetër. Aktgjykimi i gjykatës do të shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk i përmban faktet e vërtetuara, dispozitat ligjore dhe marrëdhënien logjike midis tyre (shih rastet e Gjykatës: [KI72/12, Veton Berisha dhe Ilfete Haziri](#), Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012, paragrafi 61; [KI135/14, IKK Classic](#), Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 58; [KI97/16 IKK Classic](#), Aktgjykimi i 8 dhjetorit 2017; [KI87/18](#) parashtrues *IF Skadeforsikring*, cituar më lartë, paragrafi 44; [KI138/19](#) parashtrues *Ibish Raci*, cituar më lart, paragrafi 45; si dhe rastin e Gjykatës [KI230/19](#), parashtrues *Albert Rakipi*, cituar më lartë, paragrafi 138).

i. Zbatimi i parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit konkret

55. Në këtë kontest, Gjykata vëren se në rrethanat e rastit konkret, çështja esenciale ndërlihet me çështjen e ngritur nga parashtruesi i kërkesës, sipas të cilit (i) kompania “Emona sh.p.k” nuk ka qenë pronar i markës tregtare për territorin e Republikës së Kosovës në kohën e dorëzimit të padisë; (ii) parashtruesi i kërkesës ka pasur pritje legjitime se e drejta e tij për të importuar produktin nga kompania zvicerane “Drini Tee GmbH”, buron nga regjistrimi si markë tregtare në Zvicër, duke e ndërlihur me shkelle të parimit të barazisë së armëve, si rezultat i mos marrjes parasysh të dëshmive se ai nuk është pronar i markës “Drini Tee GmbH”, me ç’ rast i njëjti ishte ngarkuar nga gjykatat e rregullta me detyrimin për largimin e produkteve të kompanisë zvicerane; si dhe (iii) duke mos respektuar çështjen e gjykuar përmes Aktvendimit të Gjykatës Themelore [C.nr. 422/488/2014] të 20 marsit 2017, është shkelur e drejta e tij për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm.
56. Rrjedhimisht, në ndërlihdje me çështjen e lartcekur, Gjykata në vazhdim do t’u referohet pjesëve relevante të aktgjyqimeve të gjykatave të rregullta, që adresojnë pretendimet e parashtruesit të kërkesës. Fillimisht, lidhur me pretendimin për “mosrespektimin e çështjes së gjykuar përmes Aktvendimit të Gjykatës Themelore [C.nr. 422/488/2014] të 20 marsit 2017”, Gjykata i referohet Aktgjykimit [Ae.nr.170/21] të 16 tetorit 2021, të Gjykatës së Apelit e cili theksoi si në vijim:

“[...] në shkresat e lëndës rezulton se gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e saj C.nr. 422, 488/2014 të datës 20/03/2017 e ka detyruar kundërshtarin e sigurimit Dogana e Kosovës, që mallin e ndaluar në bazë të Aktvendimit të datës 16/09/2014, me numër të protokollit 980/08.2.5 ZBD Ferizaj, t’ia dorëzoj në posedim dhe qarkullim të lirë propozuesit të sigurimit 'Veli Commerce', me seli në Gjilan, ndërsa nga arsyetimi i këtij Aktvendimi rezulton se sasia e mallit të liruar është 23,660 kg, prandaj gjykata e shkallës së parë gjatë vendimmarrjes nuk i ka pasur parasysh këto rrethana relevante’.

57. Në vijim, në kontekst të adresimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata vë në pah Aktgjykimin [I. EK. nr. 652/21] e 8 marsit 2022, të Gjykatës Themelore, e cila kishte arsyetuar si në vijim:

“Me dispozitat e nenit 8.1 të Ligjit për Markat Tregtare, është përcaktuar se marka e regjistruar është e drejtë ekskluzive e pronarit të saj. [...] Gjykata e ka shqyrtuar edhe pretendimin e kundërpaditësit se vendimi për regjistrimin e markës tregtare është anuluar dhe se gjate kohës sa ai vendim ishte i anuluar, mallrat e konfiskuara kanë vazhduar të qëndrojnë të ndaluara në depon doganore. Po ashtu, gjate asaj periudhe pala kundërpaditëse ka qenë e ndaluar që të tregtojë me mallra tjera, për shkak të kërkesës aktive për veprim. Mirëpo, gjykata nuk i ka marre për bazë këto pretendime, sepse vendimi regjistrimin e markës tregtare, i cili ishte anuluar me një vendim administrativ që më vonë ka rezultuar të jetë i kundërligjshëm, konsiderohet se ka qenë në fuqi, i ekzekutueshëm dhe detyruar për palët që nga dita e nxjerrjes së tij, respektivisht data 25.03.2014. Pala kundërpaditëse ka kërkuar mbrojtje gjyqësore duke u mbështetur në një vendim administrativ të anuluar nga organi i shkallës së dytë. Mirëpo, gjykata ka vlerësuar se nuk mund të mbështetet vendimi gjyqësor në një vendim që ka rezultuar të jetë i kundërligjshëm dhe që është anuluar.

Gjykata i ka shqyrtuar edhe te gjitha pretendimet e tjera nga kundërpadia. Meqenëse kundërpaditësi nuk ka arritur të argumentoj pretendimet bazike të tij se ndalimi i mallrave është bërë pa mbështetje ligjore, se paditësi nuk ka qenë bartës i markës tregtare gjate një periudhe kohore të caktuar dhe se shenja e zogut e

përdorur nga ai nuk e shkelë markën tregtare të paditësit, ka rezultuar se kërkesëpadia nuk ka bazë juridike dhe si e tillë duhet të refuzohet nga gjykata.

Me dispozitat e LMT -së, janë përcaktuar kufijtë e mbrojtjes gjyqësore të një markës të regjistruar tregtare. Neni 96, trajton çështjen e konstatimit dhe ndalimit të shkeljes, neni 97 trajton çështjen e konfiskimit dhe shkatërrimit të mallrave, neni 98 trajton çështjen e publikimit të aktgjykimit. Prandaj, ky aktgjykim është i mbështetur në dispozitat e lartpërmendura ligjore.”

58. Gjykata më tutje i referohet Aktgjykimit [Kom.Dh.Shk.II.nr.1537/22] të 17 nëntorit 2022, të Gjykatës Komerciale, Dhomat e shkallës së Dytë, e cila pretendimin e parashtruesit të kërkesës për sa i përket çështjes që (i) kompania “Emona sh.p.k” nuk ka qenë pronar i markës tregtare për territorin e Republikës së Kosovës në kohën e dorëzimit të padisë, i arsyetoi si në vijim:

“Gjykata Komerciale, dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vepruar kur ka konstatuar se me vendimin Agjencisë për Pronësi Industriale të datës 17.08.2018, ka mbet në fuqi vendimi për regjistrimin e markës tregtare me nr.12629, i dt.25.03.2014 (me efekt nga data e nxjerrjes së tij), andaj në kohën e shkeljes së ndodhur (korrik - shtator kur janë ndaluar mallrat nga Dogana e Kosovës), rezulton që marka tregtare ka qenë e regjistruar në emër të paditësit, dhe ka prezantuar bazë për të kërkuar mbrojtje gjyqësore.

Gjykata Komerciale- dhomat e shkallës së dytë i vlerësoi pretendimet ankimore të paditurit kundërpaditësit lidhur me atë se vendimi për regjistrimin e markës tregtare është anuluar dhe se gjate kohës sa i vendim ishte i anuluar, mallrat e konfiskuara kane vazhduar të qëndrojnë të ndaluara në depon doganore, si dhe gjatë asaj periudhe pala kundërpaditëse ka qenë e ndaluar që të tregtojë me mallrat e tjera për shkak të kërkesës aktive për veprim, mirëpo kjo gjykate këto pretendime i vlerësoi si të pabazuar me arsyetimin se vendimi i regjistruar i markës tregtare i cili ishte anuluar me një vendim administrativ që me vonë ka rezultuar të jetë i kundërligjshëm konsiderohet se ka qenë në fuqi i ekzekutueshëm dhe detyrues për palët që nga dita e nxjerrjes së tij nga data 25.03.2014.”

59. Më tej, në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës se (i) kompania “Emona sh.p.k” nuk ka qenë pronar i markës tregtare; (ii) se parashtruesi i kërkesës ka pasur pritje legjitime se e drejta e tij për të importuar produktin nga kompania zvicerane “Drini Tee GmbH”, si dhe (iii) duke mos respektuar çështjen e gjykuar, është shkelur e drejta e tij për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Gjykata vëren se edhe Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [E. Rev. nr.2/2023] kishte dhënë arsyetimin e saj, ku ndër të tjera arsyetoi:

“Në revizionin e të paditurit - kundër paditësit, janë paraqitur pretendime për shkelje thelbësore procedurale nga neni 182.2 pika g, të LPK-së, duke e cekur në gjykatën e instancës më të ulët kanë mbrojtur një markë tregtare e cila sipas pretendimit të paditurit - kundër paditësit në atë kohe ka qenë objekt shqyrtimi në një procedurë administrative dhe një fazë ka qenë i anuluar ky vendim. Gjykata Supreme nuk e aprovoi këtë pretendim të revizionit sepse në procedurë të mëvonshme administrative ishte konstatuar se anulimi i kësaj marke tregtare ka qenë i kundërligjshëm dhe me një vendim përfundimtar administrativ ishte shfuqizuar ky vendim për çregjistrimin e markës tregtare të paditësit - kundër paditurit. Kjo nuk i jep të drejtë të paditurit -kundër paditësit që të përdorë markën tregtare qoftë edhe në kontest administrativ, por se titulli administrativ përfundimtarë është në dobi të paditësit të kundër paditurit.
[...]

Gjykata Supreme e Kosovës pajtohet me konstatimin se nga fotot që gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se produkti i paditësit dhe të paditurit kanë ngjashmëri ndërmjet tyre dhe mundësia e shkaktimit të konfuzionit është e madhe pasi që shenja e përdorur në produktet e të paditurës asociojnë në shenjën e regjistruar si markë tregtare nga paditësja, mallrat janë të ngjashme respektivisht të së njëjtës kategori dhe ndërmarrjet janë në konkurrencë me njëra tjetrën.

[...]

Edhe pretendimet se në produktet e importuara prej të paditurit - kundër paditësit, shenja e përdorur nuk është identike me shenjën e paditësi sepse kundërpaditësi e ka tërhequr vëmendjen se mbi shenjën e zogut është i shkruar emri "Drini Tee", si dhe brenda kornizës ku ndodhet zogu gjendet emri "Drini", këto veçori dalluese i bëjnë dy shenjat e përdorura me dallime thelbësore, respektivisht jo të ngjashme me njëra tjetrën, këto pretendime kjo gjykatë i vlerësoi si të pabazuara sepse përdorimi i emërimit të biznesit në paketim ambalazh nuk e legjitimon palën në përdorimin e shenjës së huaj tregtare siç kemi të bëjmë me rastin konkret me figurën e zogut në degë.

[...]

Gjykata Supreme e Kosovës, ka vlerësuar se marka tregtare e kryen funksionin për identifikimin e prejardhjes, ndërsa qëllimi kryesor i Ligjit mbi Markat Tregtare është mbrojtja e konsumatorëve nga konfuzioni ose mashtrimi lidhur me prejardhjen e mallrave, sipas nenit 8 par. 1, nën. par. 1.2 i Ligjit mbi Markat Tregtare, pronari i një marke të regjistruar nuk ka nevojë të vërtetojë konfuzionin që faktikisht është krijuar nga përdorimi i markës identike ose të ngjashme, por vetëm mundësinë e krijimit të një konfuzioni tek konsumatorët."

60. Nga sa më sipër, Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta kanë adresuar dhe u janë përgjigjur të gjitha pretendimeve relevante të parashtruesit të kërkesës të ngritura përmes përgjigjes në padi dhe kundërpadisë, ankesës dhe kërkesës për revizion, në lidhje me çështjet se: (i) pala kundërshtare, kompania "Emona sh.p.k" nuk ka qenë pronar i markës tregtare; (ii) se parashtruesi i kërkesës ka pasur pritje legjitime se e drejta e tij për të importuar produktin nga kompania zvicerane "Drini Tee GmbH", duke e ndërlidhur me shkelje të parimit të barazisë së armëve, si rezultat i mos marrjes parasysh të dëshmimeve se ai nuk është pronar i markës "Drini Tee GmbH", me ç' rast i njëjti ishte ngarkuar nga gjykatat e rregullta me detyrimin për largimin e produkteve të kompanisë zvicerane, si dhe (iii) duke mos respektuar çështjen e gjykuar, pasi përmes Vendimit [Nr. 01/VSH] të MTI-së dhe Aktvendimit të Gjykatës Themelore [C.nr. 422/488/2014] të 20 marsit 2017, provohet që kompania "Emona sh.p.k" nuk ka qenë pronar i markës tregtare për territorin e Republikës së Kosovës në kohën e dorëzimit të padisë.
61. Në arsyetimet e gjykatave të rregullta qartazi vërehet se të njëjtat kanë arsyetuar se: (i) vendimi për regjistrimin e markës tregtare, i cili ishte anuluar me një vendim administrativ që më vonë ka rezultuar të jetë i kundërligjshëm, konsiderohet se ka qenë në fuqi, i ekzekutueshëm dhe detyrues për palët që nga dita e nxjerrjes së tij, respektivisht data 25 mars 2014; (ii) Aktgjykimet janë bazuar në dispozitat e Ligjit për Markat Tregtare ku janë përcaktuar kufijtë e mbrojtjes gjyqësore të markës të regjistruar tregtare, e ku përfshihen edhe procedura për konfiskimin dhe shkatërrimin e produkteve; (iii) me vendimin Agjencisë për Pronësi Industriale të 17 gushtit 2018, ka mbet në fuqi vendimi [nr.12629] i 25 marsit 2014, për regjistrimin e markës tregtare i (me efekt nga data e nxjerrjes së tij), andaj në kohën e shkeljes së ndodhur (korrik - shtator kur janë ndaluar mallrat nga Dogana e Kosovës), rezulton që marka tregtare ka qenë e regjistruar në emër të paditësit, dhe ka prezantuar bazë për të kërkuar mbrojtje gjyqësore.

62. Për më tepër, gjykatat e rregullta kishin sqaruar që: (iv) qëllimi kryesor i Ligjit mbi Markat Tregtare është mbrojtja e konsumatorëve nga konfuzioni ose mashtrimi lidhur me prejardhjen e mallrave, dhe se sipas nenit 8 par. 1, nën. par. 1.2 i Ligjit mbi Markat Tregtare, pronari i një marke të regjistruar nuk ka nevojë të vërtetojë konfuzionin që faktikisht është krijuar nga përdorimi i markës identike ose të ngjashme, por vetëm mundësinë e krijimit të një konfuzioni tek konsumatorët; (v) sa i përket “mosrespektimit të çështjes së gjykuar përmes Aktvendimit të Gjykatës Themelore [C.nr. 422/488/2014] të 20 marsit 2017”, Gjykata vëren që Gjykata Themelore kishte nxjerr këtë Aktvendim për masën e sigurisë të lirit të mallit nga Dogana e Kosovës, që mallin e ndaluar t’ia dorëzoj në posedim dhe qarkullim të lirë propozuesit të sigurimit, përkatësisht parashtruesit të kërkesës “*Veli Commerce*”, ndërsa nga arsyetimi i këtij Aktvendimi rezulton se sasia e mallit të liruar ishte 23,660 kg. Prandaj, nga ky Aktvendim nuk ishte vendosur për çështjen kryesore të kërkesëpadisë se a përbën apo jo shkelje të markës tregtare të paditësit, por vetëm ishte liruar sasia e mallit prej 23,660 kg, si masë e përkohshme, rrjedhimisht Aktvendimi [C.nr. 422/488/2014] nuk është “*çështje e gjykuar*”.
63. Gjykata, dëshiron të rikujtojë gjithashtu se neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6.1 i KEDNJ-së, i obligojnë gjykatat që të arsyetojnë vendimet e tyre, megjithatë, kjo nuk mund të interpretohet në mënyrë të tillë që nga ato të kërkohej përgjigje e hollësishme për secilin pretendim (shih rastet e GjEDNJ-së, *Van de Hurk kundër Holandës*, cituar më lartë; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lartë, paragrafi 26; *Jahnke dhe Lenoble kundër Francës*, nr. 40490/98, Vendim i 29 gushtit 2000, paragrafi 81).
64. Në vijim, për sa i përket pretendimit për shkelje të parimit të barazisë së armëve, Gjykata rikujton se në praktikën e saj gjyqësore dhe asaj të GjEDNJ-së është theksuar se parimi i “*barazisë së armëve*”, kërkon “*ekuilibër të drejtë midis palëve*” ku secilës palë i duhet dhënë mundësia e arsyeshme të paraqesë rastin e tij/saj nën kushtet që nuk do të vendosnin atë në disavantazh substancial *vis-a-vis* palës kundërshtare (shih rastet e Gjykatës: [KI122/19](#), me parashtrues *F.M.*, Aktvendim për Papranueshmëri i 28 gushtit 2020, paragrafi 65; [KI52/12](#), parashtrues *Adije Iliri*, Aktgjykim i 5 korrikut 2013; shih gjithashtu rastet e GjEDNJ-së: [Yvon kundër Francës](#), nr. 44962/98, Aktgjykim i 24 korrikut 2003, paragrafi 31 dhe [Dombo Beheer B. V. kundër Holandës](#), nr. 14448/88, Aktgjykimi i 27 tetorit 1993, paragrafi 33).
65. Për sa më sipër, në vlerësimin e pretendimeve që ndërlihen me shkelje të pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së, Gjykata e konsideron të rëndësishme të ritheksojë qëndrimin e përgjithshëm se “*drejtësia*” e kërkuar nga nenet e lartpërmendura nuk është drejtësi “*substanciale*”, por drejtësi “*procedurale*”. Në rrafshin praktik, koncepti i “*drejtësisë procedurale*” nënkupton: (i) mundësinë e procedurave kontradiktore/parimi i kontradiktoritetit procedural; (ii) mundësinë e palëve që në faza të ndryshme të procedurës të paraqesin argumente dhe dëshmi që i konsiderojnë të rëndësishme për rastin përkatës; (iii) mundësinë e kontestimit efikas të argumenteve dhe dëshmive të paraqitura nga pala kundërshtare; dhe (iv) të drejtën që argumentet e tyre të cilat, shikuar në mënyrë objektive, janë të rëndësishme për zgjidhjen e rastit, të dëgjohen dhe shqyrtohen nga gjykatat e rregullta në mënyrë të duhur (shih, ndër të tjera, rastin e GjEDNJ-së: [Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës](#), nr. 10590/83, Aktgjykim i 6 dhjetorit 1988, paragrafi 68; dhe rastet e Gjykatës: [KI128/19](#), parashtrues *Artan Mala*, Aktvendim për Papranueshmëri i 25 shkurtit 2021, paragrafi 58; dhe [KI22/19](#), parashtrues *Sabit Ilazi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 qershorit 2019, paragrafi 42).
66. Në këtë kontekst, Gjykata konsideron se në rastin e parashtruesit të kërkesës janë respektuar të gjitha kriteret e lartcekura nga ana e gjykatave të rregullta duke përfshirë edhe aspektin e barazisë së armëve, ku gjykatat kishin sqaruar kufijtë e mbrojtjes

gjqësore të markës tregtare, ku përmes nenit 97 (Kërkesa për konfiskimin dhe shkatërrimin e produkteve) të Ligjit për Markat Tregtare nënkupton për produktet që përbëjnë shkelje të markës tregtare të largohen nga tregu, të konfiskohen apo shkatërrohen me shpenzimet e shkelësit. Parashtruesi i kërkesës edhe me tej mund të mos jetë i kënaqur me rezultatin e gjykimit të çështjes së tyre, megjithatë, kjo pakënaqësi vetvetiu nuk mund të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, rastin e GJEDNJ-së [Mezotur-Tiszazuqi Tarsulat kundër Hungarisë](#), nr. 5503/02, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).

67. Andaj, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës, për shkelje të së drejtës për *vendim të arsyetuar*, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNJ-së, si të tilla i takojnë kategorisë së pretendimeve qartazi të pabazuara në baza kushtetuese në "*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*" ashtu siç përcaktohet me rregullin 34 (2) të Rregullores së punës.
68. Rrjedhimisht, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

(ii) Pretendimet për shkelje të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së

69. Në vijim, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon edhe shkelje të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, si rezultat i asaj që të njëjtit, i është vënë obligimi për të kompensuar kompaninë "*Emona sh.p.k*" në emër të shkeljes së markës tregtare dhe se ndërhyrja e autoriteteve publike, për shkak të procedurave arbitrare në rastin e tij, ndonëse në shikim të parë krijon përshtypjen e një veprimi legjitim dhe proporcional, në të vërtetë paraqet një ndërhyrje të paligjshme dhe arbitrare.
70. Pra, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës thekson se në emër të shkeljes së markës tregtare për shkak të procedurave arbitrare paraqet ndërhyrje të paligjshme dhe arbitrare, pasi që i njëjti përveç ndalesave për të importuar produkte, i duhet të ngarkohet financiarisht për kompensimin në emër të shkeljes së markës tregtare.
71. Në këtë drejtim, në kontekst të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, përkatësisht të drejtës në mbrojtje të pronës, Gjykata gjithashtu i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së në interpretimin e nenit 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-se. Në këtë drejtim, neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, zbatohet për pronësinë intelektuale si të tillë (shih rastin e GJEDNJ-së: [Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë](#), nr.73049/01, Aktgjykim i 11 janarit 2007, paragrafi 72). Në këtë drejtim, neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së zbatohet për një aplikim për regjistrimin e një marke tregtare edhe përpara regjistrimit të markës tregtare (shih rastin e GJEDNJ-së: [Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë](#), cituar më lartë, paragrafi 78) dhe a fortiori për markat tregtare (shih rastin e GJEDNJ-së: [Kamoy Radyo Televizyon Yayincilik ve Organizasyon A.S. kundër Turqisë](#), nr. 19965/06, Aktgjykim i 16 prillit 2019, paragrafi 37).
72. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton që Kushtetuta përmes nenit 46 garanton të drejtën e mbrojtjes së pronës, dhe në paragrafin 5 të këtij neni specifikisht përcakton se "*Prona intelektuale mbrohet me ligj*". E drejta e pronës është po ashtu e garantuar përmes nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, i cili bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, garanton të drejtën e gëzimit paqësor të "*pronës*", përfshirë garancitë që askush nuk mund të privohet nga prona e tij/saj, përveç kur është në interes publik.

73. Rrjedhimisht, Gjykata sqaron që mbrojtja ligjore e markës tregtare si pjesë përbërëse e pronës intelektuale, ndër të tjera nënkupton edhe të drejtën ekskluzive të pronarit të saj, që në rrethanat e rastit konkret përkon të ishte kompania “Emona sh.p.k”. Rrjedhimisht, në bazë të autorizimeve ligjore të nenit 96 (Procedura për konstatimin dhe ndalimin e shkeljes) dhe nenit 97 (Kërkesa për konfiskimin dhe shkatërrimin e produkteve) të Ligjit për Markat Tregtare, përcaktohen kufijtë e mbrojtjes gjyqësore të markës tregtare.
74. Prandaj, bazuar në të lartcekurat, pronarët e markës tregtare, mund të kërkojnë që produktet që përbëjnë shkelje të markës tregtare të largohen nga tregu, të konfiskohen apo shkatërrohen me shpenzimet e shkelësit, që në rastin konkret rezulton të jetë parashtruesi i kërkesës, i cili në bazë të vendimeve të gjykatave të rregullta është detyruar edhe të bëjë largimin e produkteve nga tregu. Pra, Gjykata rithekson që mbrojtja e të drejtave të pronësisë intelektuale, përfshirë të drejtën e markës tregtare, është e garantuar nga Kushtetuta. Rrjedhimisht, Kushtetuta siguron një mbrojtje të qëndrueshme dhe efektive për pronarët e markave tregtare, duke përcaktuar se ndërhyrja në këto të drejta duhet të bëhet me qëllim legjitim dhe në mënyrë proporcionale. Në këtë rast, masat e ndërmarra nga gjykatat e rregullta për të detyruar parashtruesin e kërkesës të largojë produktet që shkelin markën tregtare nga tregu, si dhe për të shkatërruar këto produkte me shpenzimet e veta, janë në përputhje me parimin e proporcionalitetit.
75. Përfundimisht, Gjykata vlerëson se pretendimet e parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese dhe kërkesa deklarohet e papranueshme, ne pajtim me rregullin 34 (2) të Rregullores së punës.

Përfundim

76. Si përmbledhje, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenet e sipërcekura të Kushtetutës, janë qartazi të pabazuara, sepse: (i) pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës lidhur me mungesën e arsytimit të vendimit gjyqësor, vlerësohen si pretendime qartazi të pabazuara; dhe (ii) pretendimet për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, vlerësohen si qartazi të pabazuara. Prandaj, kërkesa në tërësi vlerësohet e papranueshme si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullat 34 (2) dhe 48 (1)(b) të Rregullores së punës, më 01 tetor 2024, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues



Nexhmi Rexhepi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka Nimani